



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3367 / Prot.  
3

Tiranë, më 31 . 12 .2021

VENDIM  
Nr. 74 , datë 28 . 12 .2021

PËR  
“CAKTIMIN E ADMINISTRATORIT TË PËRKOHSHËM, TË UNIVERSITETIT TË  
MJEKËSISË, TIRANË”

Në mbështetje të nenit 3, 49, 51 e neneve në vijim të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të Kodit të Procedurave Administrative së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, të Udhëzimit të ministrit përgjegjës për arsimin nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme ...”, të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për vijimin normal të punës në institucion, bazuar në kriteret ligjore për pozicionin e Administratorit të institucionit, Bordi i Administrimit pas diskutimeve në mbledhjen e tij të datës 28.12.2021,

VENDOSI:

1. Znj. Alba Sako, me pozicion “Administrator i Fakultetit të Mjekësisë Dentare”, të caktohet përkohësisht në pozicionin e “Administratorit” të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (referuar edhe Vendimit të BA nr. 54, datë 31.12.2020).
2. Znj. Alba Sako do të ushtrojë detyrën si Administrator i UMT-së deri në momentin e përfundimit të procedurave të punësimit për këtë pozicion pune.
3. Ky vendim i përcillet, Senatit Akademik të UMT-së, Rektorit të UMT-së, znj. Alba Sako, njësisë kryesore të UMT-së, Drejtorisë Ekonomike dhe Drejtorisë së Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore në UMT.
4. Ngarkohet Administratori i Përkohshëm i UMT-së të përcjellë këtë vendim në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Degës së Thesarit.
5. Ngarkohen të gjithë strukturat e UMT-së për zhvillimin e të gjitha procedurave ligjore, për njohjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së nga Sektori i Koordinimit Institucional në UMT.

**KRYETAR  
ZAMIRA GJINI**

  
**ANËTARË**

**MONIKA FIDA**



**VERA OSTRENI**



**ALBANA GJINOPULLI**



**ANIS THODHORJANI**



**ALTINA XHAFERI**



**ENDRIT YZEIRAJ**

